

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Zbehet “ëndrra europiane” - Kontinenti i vjetër nuk është më i lakmueshëm, bien me 17% kërkesat për a zil në BE
ADRESA	https://www.gazetatema.net/bota/zbehet-endrra-europiane-kontinenti-i-vjeter-nuk-eshte-me-i-lakmueshem-bien--i585168
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	10 shtator 2026, 11:52:58 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	10 shtator 2026, 13:25:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	f816181db0789c3e6bc2a88bef0d9853108a8b82debc0745cb5ed943c52298e5
TEKSTI	d27ff238f42db862a1998c1c9442eef0b497d34fbc347476f2a9af5c5ee6f056
PAMJA	311cfa8d380464b86f8e2f5ed367ee51533f202627de1d5500ebdfd75d61728b

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	eb4b9ac6e4b30d158b126cc07b0779013506a00f1fa7f969a7bf425777436b2e
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/eb4b9ac6e4b30d158b126cc07b0779013506a00f1fa7f969a7bf425777436b2e>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px

- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

[English](#)

Built and Monetized by
[Kontakt](#)

[English](#)

1 e GjKKO mbyll grupin në Whatsapp të gazetareve që nuk u akredituan "Helsinki" Ieter Burgut 31.3. Jepini fund shkeljes së të drejtave të ish-presidentit Meta Iopi I Artë kthehet në "çështje shteti" të fundit

Zbehet “ëndrra europiane” - Kontinenti i vjetër nuk është më i lakmueshëm, bien me 17% kërkesat për azil në BE

10 Shtator 2026, 15:25Bota TEMA



Zbehet “ëndrra europiane” - Kontinenti i vjetër nuk

Rreth 332 mijë kërkesa për mbrojtje ndërkombëtare janë paraqitur në vendet e Bashkimit Evropian dhe në katër vendet e asociuara të zonës Shengen gjatë gjysmës së parë të vitit 2026. Shifra shënon një rënie prej 17% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Të dhënat publikohen në raportin e fundit të Agjencisë së Bashkimit Evropian për Azilin (EUAA), “Latest Asylum Trends: Mid-Year Review 2026”.

Ky është niveli më i ulët i kërkesave për azil i regjistruar në një gjashtëmujor të parë që nga viti 2021 dhe, duke përfshirur vitet e pandemisë, niveli më i ulët që nga viti 2019.

Sipas EUAA-së, rënia lidhet pjesërisht me ndryshimin e përbërjes së kombësive të aplikantëve, veçanërisht pas zhvillimeve politike në Siri, si dhe me përpjekjet e vendeve të BE-së për forcimin e bashkëpunimit me vendet e origjinës dhe të tranzitit të migrantëve.

Italia, vendi i dytë për numrin e kërkesave

Franca ishte destinacioni kryesor për aplikantët për azil gjatë gjysmës së parë të vitit, me rreth 69 mijë kërkesa, ose afërsisht një të pestën e totalit.

Në vendin e dytë renditet Italia, me rreth 66 mijë kërkesa. Pas saj vijjnë Spanja dhe Gjermania, me rreth 55 mijë kërkesa secila.

Në total, këto katër vende priten rreth 75% të të gjitha kërkesave për azil të paraqitura në hapësirën BE+, një përqindje pak më e ulët krahasuar me periudhat e mëparshme, kur këto vende përballonin rreth katër të pestat e kërkesave.

Italia mbi mesataren evropiane për numrin e kërkesave për banor

Kur të dhënat llogariten në raport me popullsinë, Italia regjistroi 1.127 kërkesa për azil për çdo milion banorë, ndërsa mesatarja për hapësirën BE+ ishte 710 kërkesa për milion banorë.

Italia renditet pranë Spanjës, Francës, Belgjikës dhe Irlandës për këtë tregues. Niveli më i lartë u regjistrua në Greqi, me 2.254 kërkesa për milion banorë.

Bangladeshasit kryesojnë në Itali

Në Itali, shtetasit e Bangladeshit vijnë në të përbjënë grupin më të madh të aplikantëve, me rreth 28 mijë kërkesa, një shifër pothuajse e pandryshuar krahasuar me periudhën e mëparshme, me një rënie prej vetëm 3%.

Ndërkohë, kërkesat e shtetasve egjiptianë u rritën me 50%, duke arritur në rreth 15 mijë. Rritje të ndjeshme u regjistruan edhe te aplikantët nga Afganistani (+77%), Kina (+43%) dhe Sri Lanka (+23%). Në të kundërt, kërkesat nga shtetasit e Marokut ranë me 22%, ndërsa ato nga Peruja me 12%.

Të dhënat e EUAA tregojnë kështu një ndryshim të rëndësishëm në dinamikën e azilit në Evropë gjatë vitit 2026, me një rënie të përgjithshme të numrit të aplikimeve, por me

ndryshime të dukshme në origjinën e aplikantëve dhe në shpërndarjen e tyre mes vendeve pritëse.

 Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[25 vjet pas '11 shtatorit': A fituan në fund terroristët?](#)

13:20 Bota

[Sllovakia i del sërish kundër BE-së, bllokoi sanksionet ndaj Rusisë](#)

12:45 Bota / 1 koment

["Njerëzimi mund të zhduket deri në vitin 2030", pas alarmit nga Anthropic ligjvënësit amerikanë sulmojnë kompanitë e AI: Shumë shqetësuese](#)

12:25 Bota / 5 komente

[Prapaskena e incidentit me Zelensky-n: droni rus, alarmi dhe avioni që nuk u nis](#)

12:15 Bota

[Prapaskena! Merz akuzon AfD-në për "spastrim etnik", anulon telefonatën me Trump pasi uroi ekstremistët](#)

11:55 Bota / 4 komente

[Avionët polakë dhe aleatë të NATO-s në gatishmëri mes alarmit ajror në Ukrainë](#)

11:15 Bota

[Irani dërgohet në Këshillin e Sigurimit të OKB-së: Vendimi i parë i këtij lloji në 20 vjet](#)

11:05 Bota / 1 koment

[Alarmi për klimën - Gushti 2026 regjistrohet si muaji më i nxehtë në histori, "El Niño" pritet të rrisë më tej tempe](#)

10:15 Bota

[Teherani kundërpërgjigjet ndaj SHBA-së, sulme ndaj anijeve luftarake dhe cisternave në Hormuz](#)

09:55 Bota

['Fjalim 1 orë e 45 minuta', Trump premton 5 mijë dollarë për çdo të rritur amerikan nëse fitojnë zgjedhjet e mesmandatit në nëntor](#)

09:35 Bota / 9 komente

Më të lexuarat

24 orët e fundit

Javën e fundit

[Republika popullore e protestës](#)

15:20 Editorial / 115 komente

[“A nuk ju vjen turp?” - Rama u përgjigjet Demokratëve Eur...](#)

11:53 Politika / 101 komente

[Emri/ Ekzekutimi i shqiptarit në Itali, ja kush është 35-...](#)

14:50 Kronika / 19 komente

[U pretendua se aktivistja u arrestua pas denoncimit të sa...](#)

15:13 Politika / 73 komente

[Liderja e AfD: Gjermania duhet të kufizojë pagesat ndaj B...](#)

13:40 Bota / 40 komente

Blog Tema

[Përse do të jetë “fair” që Erion Veliaj të lirohet](#)

12:38 Blog / 6 komente

[Veliaj përballë standardit të ri të Gjykatës së Lartë: A do të zbatohet ligji njësoj për të gjithë?](#)

10:25 Blog / 19 komente

[Dinjtet nuk ka vetëm deputeti...](#)

09:42 Blog / 22 komente

Lajme ekskluzive!

Nëse doni të jeni i pari për t'u informuar mbi lajme ekskluzive, regjistrohuni më poshtë.

Numri juaj i telefonit

REGJISTROHU

Ju mund të çregjistroheni në çdo moment.

 Powered by Tomorrow.io

TemA është një gazetë e përditshme e palidhur politikisht e botuar në Tiranë, Shqipëri në gjuhën shqipe. E themeluar në korrik 1999, TemA është një nga gazetat ditore më të vjetra në Shqipëri dhe aktualisht shet rreth 15,000 kopje ditore në mbarë vendin.



Built and Monetized by

- [Politika](#)
- [Kronika](#)
- [Editorial](#)
- [Blog](#)
- [Bota](#)
- [Sport](#)

- [Sociale](#)
- [Ekonomia](#)
- [Antena](#)
- [Rajoni](#)
- [Kulturë](#)
- [Lifestyle](#)

- [Shëndeti](#)
- [Turizëm](#)
- [Kontakt](#)
- [Te dhënat personale](#)
- [Cookies](#)

- [Dossier](#)
- [Hi-Tech](#)

Built and Monetized by

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.